



This project is funded  
by the European Union



"Hulumtim mbi bashkëpunimin  
në komunitete"

Platforma për investime në  
komunitete



Tetor, 2021  
Fondacioni Albiz





## Platforma për investime në komunitete (CIP)

Projekti mbështetet financiarisht nga Bashkimi Evropian.

Zbatues të projektit janë: Fondacioni Albiz nga Shkupi, Shoqata Multikultura nga Tetova, Qendra për Zhvillim të Qëndrueshëm të Komunitetit nga Dibra dhe Qendra për hulumtime dhe analiza NOVUS nga Strumica.

Të gjitha pikëpamjet e shprehura në këtë hulumtim janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

Botues: Fondacioni Albiz

Kompani Konsulence: SEG-HOLDING

# P Ë R M B A J T J A

Përmbledhje.....	1
Metodologjia e hulumtimit .....	4
Konstatimet e hulumtimit .....	6
Nevojat e banorëve të komunitetit .....	7
Investimet e sipërmarrjeve në komunitet .....	12
Bashkëpunimi në komunitet .....	14
Shtojcë 1. Pyetësor për organizatat qytetare .....	22
Shtojcë 2. Pyetësor për sipërmarrjet .....	25



## Përmbledhje

Qëllimi parësor i këtij hulumtimi ishte vërtetimi i bashkëpunimit të banorëve me njësitë e vetëqeverisjes lokale, duke u përqendruar në përfshirjen e banorëve në aktivitetet që i ndërmarrin vepruesit lokalë për kënaqjen e nevojave të interesit publik, koordinimit të grupeve lokale të interesit dhe bashkëpunimit me institucionet publike.

Grupet lokale të interesit shprehin nevojën dhe vullnetin për t'u përfshirë në mënyrë aktive në disejnimin e strategjive zhvillimore që i përkasin fushës së tyre, për shkak se konsiderojnë që ata më mirë i identifikojnë nevojat dhe pikat kritike për zhvillimin e bashkësisë lokale. Përveç organizatave qytetare, po kështu konsideron edhe komuniteti sipërmarrës duke theksuar rëndësinë e pjesëmarrjes së tyre me menaxhimin e programeve publike në nivel lokal, me qëllim të zgjidhjes së nevojave të tyre dhe nxitjes së rritjes ekonomike.

Analiza e investimeve të sipërmarrjeve në komunitet tregon se investimet më të shpeshta janë ato që ndikojnë në përmirësimin e produktivitetit të fuqisë punëtore (31% të investimeve në komunitet). Investimet në komunitet më shpesh realizohen në vendet dhe sektorët ku aktivitetet vijuese nuk i kënaqin tërësisht nevojat e komunitetit. Sektori publik gjithnjë e më tepër mbështetet në sektorin privat dhe shtetëror në tejkalimin e sfidave të vazhdueshme, veçanërisht kur bëhet fjalë për fuqinë punëtore dhe mungesën e shkathtësive.

Sado që të jenë të ndryshme sferat e veprimit të subjekteve lokale (politika e tregut të punës, zhvillimit ekonomik, inkuadrimin social, cilësisë së jetës) qëllimi i përbashkët i bashkëpunimit ndërmjet institucioneve publike, organizatave qytetare dhe sipërmarrjeve është përmirësimi i menaxhimit me politikat lokale, zgjidhjes kolektive të problemeve dhe kënaqjes së nevojave të palëve të prekura. Organizatat qytetare, sipërmarrjet dhe nivelet e ndryshme të qeverisjes, duhet që të lidhin bashkëpunim dhe së bashku t'i disejnojnë strategjitë sektoriale, të krijojnë politika lokale dhe të ndërmarrin iniciativa në përputhje me prioritetet e përbashkëta.

Prej analizës së mekanizmave të bashkëpunimit me të cilat ballafaqohen vepruesit kryesorë dolën sheshit problemet vijuese: mosekzistimi i një kornize kombëtare të bashkëpunimit dhe koordinim i dobët vertikal në institucionet publike; qasje jo-inkluzive të shërbimeve publike gjatë zbatimit të politikave; dhe rregullat e padefinuara të përgjegjësisë.

Institucionet lokale janë të lidhura shumë ngushtë me banorët. Ato i pranojnë kërkesat e tyre, ndërsa banorët bëjnë presion për zgjidhjen e kërkesave të veta. Ky konstelacion i marrëdhënieve ndërmjet administratës lokale, shoqërisë qytetare dhe qytetarëve domosdo imponon një konsensus të gjerë në kuadër të bashkësisë lokale.

Për të zhvilluar dhe përforcuar bashkëpunimin në nivel lokal, institucionet publike duhet t'i identifikojnë nevojat e komunitetit. Sipërmarrjet dhe sektori civil mund të paraqiten si një burim i fuqishëm informacionesh për nevojat e komunitetit lokal.

Në bazë të rezultateve të marra nga pyetësi në të cilin u përfshinë 51 organizata qytetare dhe 31 sipërmarrje nga Dibra, Strumica, Shkupi dhe Tetova, mund të vërtetohet se 45% e të anketuarve janë mirë të njoftuar me nevojat e komunitetit lokal, ndërsa 37% janë përgjigjur se janë të njoftuar pjesërisht. Nuk është e madhe përqindja e organizatave qytetare lokale dhe sipërmarrjeve që nuk janë të njoftuara me nevojat lokale, respektivisht 18%.

Analizat e rezultateve të anketës tregojnë se nevojat më të mëdha të banorëve të komunitetit janë përmirësimi i gjendjes së të rinjve dhe barazisë së grave (22% të përgjigjeve), përmirësimi i infrastrukturës lokale (22% të përgjigjeve), me çka vijon përmirësimi i shëndetësisë me 14%, arsimit me 13%, vendet e punës me 12%, shërbimet sociale me 11%, dhe ambientit jetësor me 5%.

Organizatave qytetare konsiderojnë gjithashtu se më të mëdha janë nevojat për përmirësimin e gjendjes së të rinjve dhe barazisë së grave me 29%, ndërsa sipërmarrjet konsiderojnë se më të mëdha janë nevojat për përmirësimin e infrastrukturës lokale me 33%.

Banorët në rajone të ndryshme kanë nevoja të ndryshme, por, megjithatë, si një nga prioritetet kryesore në të gjitha rajonet është përmirësimi i gjendjes së të rinjve dhe barazisë së grave.

Vlerësimi mesatar i perceptimit të organizatave qytetare dhe sipërmarrjeve për bashkëpunimin në komunitet rezulton 2.7 në shkallën prej 1 deri në 5, ku 1 është vlerësimi më i dobët, ndërsa 5 është vlerësimi më i mirë. Organizatat qytetare e vlerësojnë bashkëpunimin me 2.8, ndërsa sipërmarrjet me 2.5. Përmirësimi i bashkëpunimit me komunitetet dhe inkuadrimi i popullatës lokale në vendim-marrje dhe zbatimin të iniciativave mund të sigurojë banorët të ushtrojnë kontroll mbi zhvillimin vetanak. Politikën për zhvillim lokal janë të rregulluara kah qendra, në këtë mënyrë pjesërisht ose tërësisht është përjashtuar iniciativa e banorëve të komunitetit lokal në proceset e planifikimit dhe vendim-marrjes të qëllimeve të komunitetit lokal.

*Si pengesa kryesore për bashkëpunim shquhen:*

- ▶ *Vullneti i lirë politik i pushtetit lokal,*
- ▶ *Kapacitetet e institucioneve lokale, dhe*
- ▶ *Kultura e bashkëpunimit dhe menaxhimi i mirë.*
- ▶ *Mandati përfaqësues i përfaqësuesve të zgjedhur të vetëqeverisjes lokale.*

Metoda e bashkëpunimit më shpesh e përdorur është bashkëpunimi tradicional, në bazë të projekteve konkrete që janë dizajnuar për kënaqjen e nevojave të veçanta dhe të njëjtat nuk janë përqendruar në përfundimin e kapaciteteve të institucioneve. Ky koncept bashkëpunimi ka prirjen

të jetë i shoqëruar me një jobarazi të fuqishme ndërmjet vepruesve, nga njëra anë “Investuesit” të cilët i diktojnë rregullat e lojës, përballë banorëve lokalë të cilët kanë përfitim nga institucioni.

Këto iniciativa në përgjithësi orientohen në arritjen e rezultateve specifike, dhe, të njëjtat mjaft dobët u përshtaten nxitjes dhe përkrahjes të proceseve dhe ndryshimeve shoqërore, përforcimit të institucioneve dhe përmirësimit së qeverisjes. Të njëjtat kanë varësi të madhe nga investuesi dhe nuk tregohet kujdes që të jenë të qëndrueshme për një afat të gjatë kohor. Projekti është dizajnuar shpesh si një rast i izoluar që funksionon veçmas nga pjesa tjetër e mjedisit. Ai i ka qëllimet, resurset, buxhetin, kornizën kohore, rregullat, si dhe sistemin e monitorimit dhe evaluimit të vet, që nuk janë të integruara në instrumentet dhe mekanizmat e zhvillimit lokal.

Për të nxitur zhvillimit lokal, bashkëpunimi në nivel të projektit nevojitet të zhvillohet në nivel të politikave lokale, për çka nevojitet një përfshirje më e madhe e palëve të interesit në një komunitet gjatë procesit të sjelljes së vendimeve, definimit të qëllimeve, periudhës kohore të zbatimit, burimit të mjeteve financiare dhe menaxhimit të aktiviteteve.

*Që të zhvillohet një bashkëpunim i tillë është i nevojshëm:*

- ▶ *Përkushtimi institucional dhe vullneti i fuqishëm politik,*
- ▶ *Përfshirja e grupeve të interesit në planifikimin strategjik të politikave lokale,*
- ▶ *Krijimi i partneriteteve,*
- ▶ *Monitorimi i performancave për përfshirjen e indikatorëve për përmirësimin e kapaciteteve institucionale, dhe*
- ▶ *Evaluimi i rezultateve të përfshijë ndikimin e organizatave qytetare dhe të sipërmarrjeve në realizimin e qëllimeve lokale të institucioneve publike.*

Përkrahja shtetërore dhe resurset ndërkombëtare, gjithashtu mund të jenë kyçe për përforcimin zhvillimor të bashkësisë lokale, e cila mund të mos ketë kapacitet të veprorë si e pavarur. Bashkëpunimi ndërmjet vepruesve lokalë dhe ndërkombëtarë çon drejt një qëndrueshmërie të përmirësuar të projekteve zhvillimore. Shpesh banorët lokalë kanë ndikim të madh në komunitetin e tyre dhe mund të ndihmojnë në promovimin e iniciativave zhvillimore përmes rrjeteve joformale lokale me sukses më të madh, në vend të veprimit të pavarur të palëve ndërkombëtare.

Përmes debatit të hapur publik mund të gjenden zgjidhje për sfidat kryesore me të cilat ballafaqohen komunitetet. Debati duhet të zhvillohet në nivel lokal, aty, afër problemeve dhe individëve, sepse bashkëpunimi në nivel lokal më së shpeshti bëhet në të mirë të zgjidhjes së çështjeve me implikime kolektive siç janë: zhvillimi ekonomik, punësimi, kohezioni social dhe cilësia e jetesës.



## Metodologjia e hulumtimit

Hulumtimi i bashkëpunimit në komunitet është realizuar përmes mbledhjes dhe analizës së të dhënave cilësore me qëllim që të merren informata të perceptimit të banorëve për bashkëpunimin në komunitet, si dhe metoda sasiore e mbledhjes së të dhënave me qëllim që të merren informata për të dhëna statistikore dhe pasqyrës më të plotë të gjendjes.

Rajonet e përcaktuara ishin Dibra, Strumica, Shkupi dhe Tetova. Në këtë hulumtim është kushtuar kujdes që të gjitha rajonet të përfshihen përafërsisht në mënyrë të barabartë.

Si burime parësore të të dhënave janë shfrytëzuar anketat e organizatave qytetare dhe sipërmarrjeve. Gjatë hartimit, për anketimin është përdorur parimi që organizatat qytetare të jenë aktive në bashkësitë lokale, ndërsa parimi në bazë të të cilit janë definuar sipërmarrjet është që të njëjtat duhet të kenë përgjegjësi shoqërore - sipërmarrjet sociale, organizatat të cilat bëjnë donacione filantropike, ose në një mënyrë tjetër joformale investojnë në komunitet përmes modeleve tjera joformale dhe që kërkojnë një bashkëpunim të mirë në komunitet.

Për nevojat e hulumtimit, në bazë të hulumtimit nga zyra, janë përfshirë 68 organizata qytetare dhe 50 sipërmarrje në rajonet e përcaktuara me qëllim të marrjes së të dhënave relevante. Pas dorëzimit të pyetësorëve përgjigjet janë marrë nga 51 organizata qytetare dhe 31 sipërmarrje.

Me dorëzimin e pyetësorëve të dy grupet e interesit të dhënat janë marrë nga dy këndvështrime të ndryshme, siç janë banorët e komunitetit të përfaqësuar nga organizatat qytetare si grupe të interesit në procesin e bashkëpunimit dhe përfaqësuesve të sipërmarrjeve si grupe interesi që bashkëpunojnë dhe investojnë në komunitet.

- ▶ Mbledhja e të dhënave është bërë përmes:
- ▶ Hulumtimit nga zyra për hartimin e të dhënave burimore.
- ▶ Pyetësorit i cili i është dorëzuar organizatave qytetare.
- ▶ Pyetësorit i cili i është dorëzuar sipërmarrjeve.
- ▶ Hulumtimit nga zyra për indikatorët që do të shfrytëzohen gjatë investimeve në komunitet.
- ▶ Intervistave gjysmë të strukturuar tek një pjesë e sipërmarrjeve që ishin anketuar më parë.
- ▶ Studimet e rasteve që ishin bërë në bazë të të dhënave të marra nga intervistat.

Me anketimin e organizatave qytetare qëllimi parësor ishte që të merren informata për perceptimin e banorëve në kuadër të bashkëpunimit në komunitet. Me pyetësin i cili iu dorëzua organizatave qytetare u morën informata për: Информираноста на граѓанските организации за потребите на жителите на задниците.

- ▶ Informimin e organizatave qytetare për nevojat e banorëve të komunitetit.
- ▶ Nevojat e banorëve të komunitetit.
- ▶ Investimet në komunitet.
- ▶ Bashkëpunimin e komunës dhe të institucioneve shtetërore me banorët, sipërmarrjet dhe organizatat qytetare.

Me anketimin e sipërmarrjeve qëllimi parësor ishte që të merren informata për perceptimin e sipërmarrjeve në kuadër të bashkëpunimit në komunitet. Me pyetësin, i cili iu dorëzua sipërmarrjeve, u morën informata për: Инвестициите во заедницата од страна на приватниот сектор.

- ▶ Investimet në komunitet nga ana e sektorit privat.
- ▶ Përfitimet e sipërmarrjeve nga investimi në komunitet.
- ▶ Nevojat e banorëve të komunitetit.
- ▶ Bashkëpunimi i komunës dhe i institucioneve shtetërore me banorët, sipërmarrjet dhe organizatat qytetare.
- ▶ Informacionet kyçe për hartimin e studimeve të mundshme të rasteve


Pas mbledhjes së të dhënave, për analizë është përdorur metoda sasiore përshkuese dhe analiza cilësore e përmbajtjes së përgjigjeve.

## Konstatimet e hulumtimit

Në bazë të pyetësorit, të cilit i janë përgjigjur 51 organizata qytetare dhe 31 sipërmarrje nga Dibra, Strumica, Shkupi dhe Tetova, mund të shihet se 45% e të anketuarve janë të njohur mirë me nevojat e komunitetit lokal dhe 37 % janë të njohur pjesërisht. Nuk është e madhe përbindja e organizatave qytetare lokale dhe e sipërmarrjeve që nuk janë të njohura me nevojat lokale, respektivisht 18 %. Nuk ekziston dallim i madh në nivelin e njohjes me nevojat e banorëve, ndërmjet sipërmarrjeve lokale dhe organizatave qytetare.

Gjithashtu, 75% e organizatave qytetare konsiderojnë se banorët u drejtohen atyre për përkrahje ose për zgjidhjen e problemeve të komunitetit. Në raport me investimet në komunitet, 28% e organizatave qytetare kishin informata dhe/ose kanë bashkëpunuar me sipërmarrje që kanë investuar në komunitet. Organizatat qytetare vunë në dukje organizata të cilat investojnë në komunitet, si për shembull: **Pokrov, Izbor, Maj pica DOOEL (Slice), Eftinia Impeks, Knauf, Diecopek, Ekolog, Kiper, Renova, Dauti Komerc, Dukas Kompani dhe Dash Komerc.**

**Grafiku 1. Njohja e organizatave qytetare dhe sipërmarrjeve me nevojat e komunitetit lokal.**



**Burimi: Anketë për bashkëpunimin e organizatave qytetare dhe Anketë për bashkëpunimin e sipërmarrjeve**


## Nevojat e banorëve të komunitetit

Nga rezultatet e përgjithshme të anketës mund të shihet se nevoja më e madhe e banorëve të komunitetit është përmirësimi i gjendjes së të rinjve dhe barazisë së grave dhe përmirësimit të infrastrukturës lokale me nga 22% të përgjigjeve, me çka vijon përmirësimi i shëndetësisë me 14%, arsimit me 13%, vendeve të punës me 12%, shërbimeve sociale me 11% dhe ambientit jetësor me 5%.

Organizatave qytetare konsiderojnë se nevojat më të mëdha janë për përmirësimin e gjendjes së të rinjve dhe barazisë së grave me 29%, me çka vijon infrastruktura lokale dhe shërbimet sociale me nga 14%, shëndetësia me 12%, arsimit me 11%, vendet e punës me 9% dhe ambienti jetësor dhe ndryshimet klimatike me 8%.

Sipërmarrjet konsiderojnë se nevojat më të mëdha janë për përmirësimin e infrastrukturës lokale me 33%, me çka vijon shëndetësia me 18%, arsimit dhe vendet e punës me nga 16%, gjendja e të rinjve dhe barazia e grave me 10% dhe shërbimet sociale me 6%.

**Grafiku 2. Nevojat e banorëve të komunitetit**



**Burimi: Anketë për bashkëpunim me organizatat qytetare dhe Anketë për bashkëpunim me sipërmarrjet**

Me krahasimin e përgjigjeve të pyetjes së njëjtë ndërmjet organizatave qytetare dhe sipërmarrjeve mund të shihet se ekziston dallimi ndërmjet perceptimit të organizatave qytetare dhe sipërmarrjeve.


Organizatave qytetare besojnë se gjendja e të rinjve dhe barazia e grave është prioriteti më i madh për çka janë deklaruar 29%, ndërsa vetëm 10% e sipërmarrjeve e kanë theksuar këtë nevojë.

Për sipërmarrjet nevoja më e madhe është përmirësimi i infrastrukturës lokale i cili do të sjellë zhvillim ekonomik.

Në rajonin e Dibrës në pyetjen për nevojat e komunitetit lokal u morën 38 përgjigje nga organizatat qytetare dhe sipërmarrjet (kishin mundësinë të përcaktojnë dy prioritete).

Nga rezultatet mund të shihet se nevoja më e madhe e banorëve të komunitetit është përmirësimi i infrastrukturës lokale me 29% të përgjigjeve, me çka vijon përmirësimi i gjendjes me vendet e punës me 18%, shërbimet sociale dhe shëndetësia me 13%, arsimit dhe gjendja e të rinjve dhe e grave me nga 11% dhe ambienti jetësor dhe ndryshimet klimatike me 5%. Nga përgjigjet shihet se në rajonin e Dibrës zhvillimi ekonomik përmes përmirësimit të infrastrukturës lokale dhe krijimit të vendeve të punës është prioritet për të gjitha palët e prekura.

**Grafiku 3. Nevojat e banorëve të komunitetit në rajonin e Dibrës**




**Burimi: Anketë për bashkëpunim me organizatat qytetare dhe Anketë për bashkëpunim me sipërmarrjet**

E analizuar me krahasimin e përgjigjeve të organizatave qytetare dhe sipërmarrjeve mund të shikohet se organizatat qytetare pjesën më të madhe të fokusit të vet për zhvillim e vendosin në shërbimet sociale dhe gjendjen e të rinjve si dhe barazisë së grave për dallim nga sipërmarrjet, ndërsa sipërmarrjet fokusin më të madh të nevojave e vendosin në arsim dhe vendet e punës.

Në rajonin e Shkupit në pyetjen për nevojat e komunitetit lokal u morën 39 përgjigje nga organizatat qytetare dhe sipërmarrjet (kishin mundësinë të përcaktojnë dy prioritete). Nga rezultatet mund të shihet se nevoja më e madhe e banorëve të komunitetit është përmirësimi i gjendjes së të rinjve dhe barazisë së grave me 28% të përgjigjeve, me çka vijon përmirësimi i gjendjes së arsimit me 23%, infrastruktura lokale me 21%, vendet e punës me 13%, shëndetësia me 10% dhe shërbimet sociale si dhe ambienti jetësor me nga 3%.

**Grafiku 4. Nevojat e banorëve të komunitetit në rajonin e Shkupit**




**Burimi: Anketë për bashkëpunim me organizatat qytetare dhe Anketë për bashkëpunim me sipërmarrjet**

Nga përgjigjet shihet që në rajonin e Shkupit ekziston një dallim i konsiderueshëm i perceptimit ndërmjet organizatave qytetare dhe sektorit privat në raport me infrastrukturën lokale (në shumë prej 32 për qind të pikëve). Për sipërmarrjet prioritet më i madh është infrastruktura lokale, ndërsa për organizatat qytetare gjendja e të rinjve dhe grave si dhe arsimit.

Në rajonin e Strumicës në pyetjen për nevojat e komunitetit lokal u morën 25 përgjigje nga organizatat qytetare dhe sipërmarrjet (kishin mundësi të përcaktojnë dy prioritete).

Nga rezultatet mund të shihet se nevoja më e madhe e banorëve të komunitetit është përmirësimi i gjendjes së të rinjve dhe barazisë së grave me 24% të përgjigjeve, me çka vijon përmirësimi i gjendjes së arsimit dhe shërbimet sociale me nga 20%, infrastruktura lokale dhe shëndetësia me nga 12% dhe vendet e punës e ambienti jetësor me 4%.

**Grafiku 5. Nevojat e banorëve të komunitetit në rajonin e Strumicës**




**Burimi: Anketë për bashkëpunim me organizatat qytetare dhe Anketë për bashkëpunim me sipërmarrjet**

Nga përgjigjet shihet se në rajonin e Strumicës si dhe në rajonet tjera ekziston një dallim i konsiderueshëm i perceptimit ndërmjet organizatave qytetare dhe sektorit privat në raport me infrastrukturën lokale. Për sipërmarrjet prioritet më i madh është infrastruktura lokale.

Në rajonin e Tetovës në pyetjen për nevojat e komunitetit u morën 23 përgjigje nga organizatat qytetare dhe sipërmarrjet (kishin mundësinë të përcaktojnë dy prioritete).

Nga rezultatet mund të shihet se nevoja më e madhe banorëve të komunitetit është përmirësimi i gjendjes së të rinjve dhe barazia e grave me 26% të përgjigjeve, me çka vijon përmirësimi i gjendjes të shëndetësisë me 17%, infrastruktura lokale, arsimi dhe vendet e punës me nga 13% dhe shërbimet sociale e ambienti jetësor me nga 9%.

Grafiku 6. Nevojat e banorëve të komunitetit në rajonin e Tetovës



Burimi: Anketë për bashkëpunim me organizatat qytetare dhe Anketë për bashkëpunim me sipërmarrjet



## Investimet e sipërmarrjeve në komunitet

Pyetësorit iu përgjigjën 31 sipërmarrje në Dibër, Strumicë, Shkup dhe Tetovë. Veprimtaria themelore e sipërmarrjeve ndodhet në sektorë të ndryshëm ekonomikë si në: ndërtimtari, distribuim me pakicë dhe shumicë, objekte akomoduese dhe veprimtari shërbyese, informacion dhe komunikim, industri përpunuese, veprimtari profesionale, shkencore dhe teknike, transport dhe magazinim, tregti me shumicë e pakicë, veprimtari financiare, të sigurimit etj.

Nga përgjigjet mund të shihet se 16 sipërmarrje kanë investuar në komunitet, respektivisht 52% të anketuesve. Sipërmarrjet investuan në fusha të ndryshme siç janë krijimi i vendeve të punës për popullatën lokale, arsimin, infrastrukturën lokale, aktiviteteve sportive dhe kulturore, mbrojtjes së ambientit jetësor, ndihmës së kategorive të cenueshme të personave, rinovimit të shtëpive, trajnimit të popullatës vendore etj.

Prej gjashtëmbëdhjetë sipërmarrjeve të cilat kanë investuar në komunitet 75% i njohin mirë nevojat e komunitetit dhe të gjitha investimet janë bërë për kënaqjen e nevojave të tyre. Gjithashtu 94%, respektivisht 15 nga 16 sipërmarrje me kënaqjen e nevojave të komunitetit kanë pasur realizim direkt ose indirekt të qëllimeve të tyre afariste.


Duhet patur parasysh se gjatë analizës nuk është marrë parasysh rëndësia e investimit në realizimin e nevojave të sipërmarrjeve edhe pse te një pjesë e të anketuarve vetë modeli i biznesit ka të bëjë në plotësimin e nevojave të komunitetit.

Analiza e qëllimeve afariste të sipërmarrjeve të cilat janë realizuar nga investimet në komunitet tregoi se përfitimet për sipërmarrjet te 31% e përgjigjeve është produktiviteti i fuqisë lokale, 18% është për përmirësimin e reputacionit, 18% për përparësinë konkurruese, 16% menaxhimi me rreziqet e sipërmarrjeve, 11% është përcjellja e standardeve globale në industri dhe 7% është qasjet në miratimet dhe kapitalin.

Edhe pse një investim mund të ndikojë në më shumë qëllime afariste më shpesh me përfitime të produktivitetit të fuqisë punëtore lokale nënkuptohen llojet e ndryshme të trajnimeve të personave të papunësuar, investimeve në arsim përmes blerjes së librave, bursave, investimeve në infrastrukturën arsimore lokale, rehabilitimit profesional të kategorive të cenuara të tregut të punës etj.

Në raport me reputacionin dhe përparësitë konkurruese më së shpeshti sipërmarrjet investojnë me qëllim që komuniteti lokal t'i njohë si pjesë e tij dhe si sipërmarrje që kujdesen dhe u ndihmojnë popullatës lokale. E njëjta sjell një plasman më të mirë të produkteve dhe shërbimeve të veta te popullata lokale.

**Grafiku 7. Përfitimet e sipërmarrjeve nga investimet në komunitetin lokal**



**Burimi: Anketë për bashkëpunim me sipërmarrjet**

Duke vështruar sipas rajoneve, më së shumti investimet në komunitet janë për sigurimin e fuqisë punëtore më të mirë në ç’mënyrë do përmirësohej rrjeti afarist dhe sipërmarrjet do të kishin një rritje të pandalshme.


Nga të dhënat mund të shihet se investimet e sipërmarrjeve në rajonin e Dibrës para së gjithash ndikojnë në reputacionin më të mirë me 32% dhe përmirësohet produktiviteti i popullatës lokale me 26%. Gjithashtu investimet ndikuan në rreziqet e sipërmarrjeve me 16%, qasjet në miratimet dhe kapitalin me 16% dhe përparësi konkurruese me 11%.

Në rajonin e Shkupit me investimet është përmirësuar produktiviteti i fuqisë punëtore në 33% të rasteve, ndërsa në 17% të rasteve me anë të investimit është ndikuar në reputacion, qasjet në miratimet dhe kapitalin, përparësinë konkurruese dhe menaxhimin me rreziqet.

Në rajonin e Strumicës ndikimi në qëllimet afariste në 33% të përgjigjeve ka qenë për produktivitetin e fuqisë punëtore, në 22% për përparësitë konkurruese dhe përcjelljes së standardeve globale dhe industrisë, në 11% të përgjigjeve për reputacion dhe menaxhim me rreziqe.

Në rajonin e Tetovës 40% e investimeve kanë ndikuar në produktivitetin e fuqisë punëtore, ndërsa 20% në reputacion, përparësinë konkurruese dhe menaxhimin me rreziqet.

**Grafiku 8. Përfitimet e sipërmarrjeve prej investimit në bashkësinë lokale sipas rajoneve**



**Burimi: Anketë për bashkëpunim me sipërmarrjet**

Nga analiza e investimeve në sektorin privat sipas rajoneve mund të shihet se pjesa më e madhe e investimeve orientohen drejt tregut të punës dhe të njëjtat bazohen në mospërshtatjen e ofertës dhe kërkesës. Të njëjtat e theksojnë bashkëpunimin e dobët të sektorit privat me institucionet publike në nivel lokal.

**Bashkëpunimi në komunitet**


Hulumtimi mbi bashkëpunimin në komunitet realizohet nëpërmjet mbledhjes dhe analizës së të dhënave cilësore me qëllim që të merren informata për perceptimin e bashkëpunimit ndërmjet pushtetit lokal, organizatave qytetare, banorëve dhe sipërmarrjeve si veprues kryesorë të bashkëpunimit në komunitet. Gjithashtu u morën edhe të dhëna cilësore nga sipërmarrjet dhe organizatat qytetare të bazuara nga përvoja e tyre për një pasqyrë më të plotë të situatës.

Me pyetësonin e dorëzuar u morën informata sasiore nga organizatat qytetare dhe sipërmarrjet të cilat mundën ta vlerësojnë bashkëpunimin me notë nga 1 deri në 5, ku 1 paraqet notën e pakënaqshme, ndërsa 5 paraqet notën shkëlqyeshëm. Gjithashtu, organizatat qytetare dhe sipërmarrjet mund të arsyetonin pse janë të kënaqura, ose pse nuk janë të kënaqura nga bashkëpunimi, me çka u morën të dhëna cilësore në nivel lokal. Pyetësorit iu përgjigjën 82 organizata prej të cilave 51 organizata qytetare dhe 31 sipërmarrje.

Nota mesatare e perceptimit të organizatave qytetare dhe sipërmarrjeve për bashkëpunimin në komunitet rezulton 2.7 në shkallën prej 1 deri në 5. Organizatat qytetare e vlerësojnë bashkëpunimin me 2.8, ndërsa sipërmarrjet me 2.5. Nga përgjigjet e përgjithshme të organizatave qytetare dhe sipërmarrjeve mund të shihet se 22% e vlerësojnë gjendjen me notën 1, 19% e vlerësojnë gjendjen me notën 2, 33% e vlerësojnë gjendjen me notën 3, 19% e vlerësojnë gjendjen me notën 4 dhe 7% e vlerësojnë me notën 5. Te përgjigjet e organizatave qytetare, 19% e të anketuarve e vlerësojnë gjendjen me notën 1, 17% e vlerësojnë gjendjen me notën 2, 37% e vlerësojnë gjendjen me notën 3, 19% e vlerësojnë gjendjen me notën 4, dhe 9% e vlerësojnë gjendjen me notën 5. Nota mesatare rezulton 2.8.

Te përgjigjet e përfaqësuesve të sipërmarrjeve 29% e të anketuarve e vlerësojnë gjendjen me notën 1, 23% e vlerësojnë gjendjen me notën 2, 26% e vlerësojnë gjendjen me notën 3, 20% e vlerësojnë gjendjen me notën 4, dhe 3% e vlerësojnë gjendjen me notën 5. Nota mesatare rezulton 2.5 në shkallën prej 1 deri në 5.

**Grafiku 9. Pasqyra e bashkëpunimit të përfaqësuesve të sipërmarrjeve dhe të organizatave qytetare në komunitet**



**Burimi: Anketë për bashkëpunim me organizatat qytetare dhe Anketë për bashkëpunim me sipërmarrjet, si dhe llogaritje të autorit në bazë të të dhënave nga anketat**

Nga grafiku mund të shihet se bashkëpunimi i organizatave qytetare dhe sipërmarrjeve është në nivel të dobët. Vlerësimi për bashkëpunimin e organizatave qytetare është pak më i mirë në raport me vlerësimin e sipërmarrjeve me 3 për qind të pikëve. Vetëm një sipërmarrje e ka vlerësuar bashkëpunimin me notën 5.

Një pjesë e organizatave qytetare konsiderojnë se komunat në buxhetet e tyre vjetore nuk sigurojnë mjete të mjaftueshme për sektorin civil, se nuk ka vullnet politik për bashkëpunim, bashkëpunimi nuk është i rregullt, komunat nuk i shohin organizatat qytetare si partnerë, bashkëpunimin e definojnë në bazë të përkatësisë politike dhe se nuk ekziston kulturë bashkëpunimi.

Një pjesë më e vogël e organizatave qytetare konsiderojnë se bashkëpunimi është i mirë dhe së bashku marrin pjesë në projekte me të cilat i zgjidhin problemet e qytetarëve, se çdo herë janë të disponueshëm për bashkëpunim si dhe ka një bashkëpunim të mirë për zgjidhjen e problemeve të të rinjve, të arsimit joformal dhe të aksioneve ekologjike.

Mendimi i organizatave qytetare më i plotë mund të tregohet përmes dy mendimeve të organizatave qytetare si më poshtë:


*“Në vitet e kaluara ishte vendosur një praktikë bashkëpunimi ndërmjet institucioneve dhe sektorit civil nëpërmjet programit vjetor në të cilin qenë përfshirë thirrjet për projekte, bashkëpunim të strategjive, aktivitete të përbashkëta dhe ngjashëm, por vitet e fundit situata ka ndryshuar dhe momentalisht bashkëpunimi me sektorin qytetar është reduktuar në ftesa nëse u nevojiten statistë për ndonjë ngjarje ose nëse organizata ka aktivitete të projektit përmes së cilave institucionet do të mund t’i shfrytëzojnë për promovim vetanak ose që të shprehen deklarativisht se ka bashkëpunim. Një pjesë e mjeteve vendore që më parë i kishin në dispozicion organizatat qytetare tani rialokohen tek klubet sportive (të cilat janë të regjistruara si shoqata ose ngj.) Ekzistojnë edhe përjashtime, dhe, kjo, para së gjithash, ka të bëjë vetëm me menaxherët e atyre institucioneve të cilët janë të vetëdijshëm për nevojën e bashkëpunimit” – Sektori joqeveritar*

*„ Bashkëpunimi i institucioneve varon nga vetë situata konkrete, disa institucione janë të hapura për qytetarët, sipërmarrjet dhe organizatat qytetare, me të cilat janë krijuar raporte solide, duke filluar nga memorandumet e bashkëpunimit deri te aktivitetet konkrete në projekte, iniciativa dhe aksione të ndryshme. Por, një pjesë më e madhe e institucioneve, veçanërisht ato lokale, nuk janë të hapura përherë për një nivel direkt dhe produktiv bashkëpunimi. Përveç vështirësive në procesin e krijimit të raporteve dhe kontakteve, ekzistojnë edhe sfida administrative, byrokratike, shpërqëndrim të proceseve të lidhura drejtpërdrejt me veprimin e tyre, të cilat si pasojë, kanë ndikim gjatë implementimit të iniciativave dhe projekteve konkrete, duke patur parasysh se këto projekte zakonisht kufizohen nga korniza kohore”- Sektori joqeveritar*

Nga grafiku numër 9 mund të shihet se perceptimi i sipërmarrjeve për bashkëpunim është në nivel të ulët. Pjesa më e madhe e sipërmarrjeve konsiderojnë se përpjekjet për bashkëpunim përfundojnë me premtime dhe pa aktivitete reale, se favorizohen njëmendësit politikë, institucionet shtetërore janë shumë të mbyllura për qytetarët dhe qytetarët kanë besim shumë të vogël në institucionet, nuk ka vazhdimësi në bashkëpunim dhe se kanë kapacitete të dobëta për bashkëpunim. Një pjesë më e vogël e sipërmarrjeve konsiderojnë se ka bashkëpunim të mirë në fushën e ambientit jetësor, artit dhe kulturës si dhe grante për nisjen e bizneseve të reja.

Duke analizuar në nivel rajonal në rajonin e Dibrës nota mesatare për bashkëpunim në komunitet rezulton 2.6. Te sipërmarrjet nota mesatare e bashkëpunimit është 2.5, ndërsa te organizatat qytetare 2.7. Nga të gjitha përgjigjet, 33% të anketuesve e vlerësojnë gjendjen me notën 1, 13% e vlerësojnë gjendjen me notën 2, 21% e vlerësojnë gjendjen me notën 3, 29% e vlerësojnë gjendjen me notën 4, dhe 4% e vlerësojnë gjendjen me notën 5. Te përgjigjet e organizatave qytetare 38% e të anketuarve e vlerësojnë gjendjen me notën 1, 8% e vlerësojnë gjendjen me notën 2, 23% e vlerësojnë gjendjen me notën 3, 23% e vlerësojnë gjendjen me notën 4, dhe 8% e vlerësojnë gjendjen me notën 5. Nota mesatare rezulton 2.7. Te përgjigjet të përfaqësuesve të sipërmarrjeve, 27% e të anketuarve e vlerësojnë gjendjen me notën 1, 18% e vlerësojnë gjendjen me notën 2, 18% e vlerësojnë gjendjen me notën 3, 26% e vlerësojnë gjendjen me notën 4, dhe 0% e vlerësojnë gjendjen me notën 5. Nota mesatare rezulton 2.5 në shkallë prej 1 deri në 5.

#### 10. Pasqyra e bashkëpunimit të përfaqësuesve të sipërmarrjeve dhe të organizatave qytetare në komunitet, në rajonin e Dibrës.




**Burimi: Anketë për bashkëpunim me organizatat qytetare dhe Anketë për bashkëpunim me sipërmarrjet, si dhe llogaritje të autorit në bazë të të dhënave nga anketat**

Nga grafiku mund të shihet se bashkëpunimi i organizatave qytetare dhe sipërmarrjeve është në nivel të ulët. Vlerësimi i bashkëpunimit të organizatave qytetare është pak më i mirë në raport me vlerësimin e sipërmarrjeve dhe atë për 0.2 pikë. Asnjë sipërmarrje nuk e ka vlerësuar bashkëpunimin me notën 5. Organizatat qytetare konsiderojnë se bashkëpunimi është i dobët, nuk janë të informuar për aktivitetet e komunitetit lokal dhe se autoritetet nuk kujdesen për nevojat e banorëve. Si një shembull pozitiv e vënë në pah pastrimin e liqenit të Dibrës dhe deponitë jolegale. Sipërmarrjet konsiderojnë se bashkëpunimi është i dobët dhe se nuk ka kapacitete institucionale, se nuk ndërmerren masa dhe se po favorizohen njerëz me njëmendësi partiake, ndërsa aksionet ekologjike i dallojnë si një shembull pozitiv. Në rajonin e Shkupit nota mesatare në komunitet rezulton 2.6. Te sipërmarrjet nota mesatare për bashkëpunim është 2.5, ndërsa te organizatat qytetare 2.7. Nga të gjitha përgjigjet, 18% e anketuesve e vlerësojnë gjendjen me notën 1, 18% e vlerësojnë gjendjen me notën 2, 50% e vlerësojnë gjendjen me notën 3, 14% e vlerësojnë gjendjen me notën 4, dhe 0% e vlerësojnë gjendjen me notën 5.

Te përgjigjet e organizatave qytetare, 23% e anketuesve e vlerësojnë gjendjen me notën 1, 8% e vlerësojnë gjendjen me notën 2, 54% e vlerësojnë gjendjen me notën 3, 15% e vlerësojnë gjendjen me notën 4, dhe 0% e vlerësojnë gjendjen me notën 5. Nota mesatare rezulton 2.7. Te përgjigjet e përfaqësuesve të sipërmarrjeve 11% e të anketuarve e vlerësojnë gjendjen me notën 1, 33% e vlerësojnë gjendjen me notën 2, 44% e vlerësojnë gjendjen me notën 3, 11% e vlerësojnë situatën me notën 4, dhe 0% e vlerësojnë situatën me notën 05. Nota mesatare rezulton 2.5 në shkallën prej 1 deri në 5.

**Grafiku 11. Pasqyra e bashkëpunimit të përfaqësuesve të sipërmarrjeve dhe të organizatave qytetare në komunitet, në rajonin e Shkupit**



**Burimi: Anketë për bashkëpunim me organizatat qytetare dhe Anketë për bashkëpunim me sipërmarrjet, si dhe llogaritje të autorit në bazë të të dhënave nga anketat**

Nga grafiku mund të shihet se bashkëpunimi i organizatave qytetare dhe sipërmarrjeve është në nivelin e ulët. Vlerësimi për bashkëpunimin e organizatave qytetare është pak më e mirë në raport me vlerësimin e sipërmarrjeve me 0.2 pikë. Asnjë sipërmarrje dhe organizatë qytetare nuk e ka vlerësuar bashkëpunimin me notën 5.

Organizatave qytetare konsiderojnë se bashkëpunimi është i dobët, nuk ka komunikim të rregullt, nuk ka kulturë bashkëpunimi ndërmjet institucioneve publike, sipërmarrjeve dhe organizatave qytetare. Si shembuj pozitivë e theksojnë bashkëpunimin në arsimin joformal dhe sigurimit të lokaleve për punë.

Sipërmarrjet konsiderojnë se iniciativat mbarojnë pas disa takimeve dhe se shpesh ndërrohen kompetencat dhe përgjegjësitë të personave në komuna dhe institucionet shtetërore që ndikon në vazhdimësinë e bashkëpunimit. Si shembull pozitiv theksohet bashkëpunimi për përmirësimin e kushteve në institucionet arsimore.


Në rajonin e Strumicës nota mesatare për bashkëpunim në komunitet rezulton 3.5. Te sipërmarrjet nota mesatare për bashkëpunim është 3.0, ndërsa te organizatat qytetare 3.8. Nga të gjitha përgjigjet, 8% e të anketuarve e vlerësojnë gjendjen me notën 1, 8% e vlerësojnë gjendjen me notën 2, 31% e vlerësojnë gjendjen me notën 3, 31% e vlerësojnë gjendjen me notën 4, dhe 23% e vlerësojnë gjendjen me notën 5.

Te përgjigjet e organizatave qytetare 0% e anketuesve e vlerësojnë gjendjen me notën 1, 6% e vlerësojnë gjendjen me notën 2, 35% e vlerësojnë gjendjen me notën 3, 29% e vlerësojnë gjendjen me notën 4, 29% e vlerësojnë gjendjen me notën 5. Te përgjigjet e përfaqësuesve të sipërmarrjeve 22% e vlerësojnë gjendjen me notën 1, 11% e vlerësojnë gjendjen me notën 2, 22% e vlerësojnë gjendjen me notën 3, 33% e vlerësojnë gjendjen me notën 4, dhe 11% e vlerësojnë gjendjen me notën 5.

Nga grafiku 12 mund të shihet se bashkëpunim i organizatave qytetare dhe sipërmarrjeve është në nivel më të mirë në raport me komunat tjera. Vlerësimi i bashkëpunimit të organizatave qytetare është më i mirë në raport me vlerësimin e sipërmarrjeve edhe atë për 0.8 pikë.



**Grafiku 12. Pasqyra e bashkëpunimit të përfaqësuesve të sipërmarrjeve dhe të organizatave qytetare në komunitet, në rajonin e Strumicës**




**Burimi: Anketë për bashkëpunim me organizatat qytetare dhe Anketë për bashkëpunim me sipërmarrjet, si dhe llogaritje të autorit në bazë të të dhënave nga anketat**

Organizatave qytetare janë të kënaqura nga bashkëpunimi dhe theksojnë se pushteti lokal është i gatshëm për bashkëpunim. Sipërmarrjet konsiderojnë se duhet të ketë një bashkëpunim më të mirë me sipërmarrjet, ndërsa si një shembull pozitiv i cekin grantet për nisjen e bizneseve të reja.

Analizuar në nivel rajonal në rajonin e Tetovës nota mesatare e bashkëpunimit në komunitet rezulton 1.9. Te sipërmarrjet nota mesatare e bashkëpunimit është 1.8, ndërsa te organizatat qytetare 2.0. Nga të gjitha përgjigjet, 37% e të anketuarve e vlerësojnë gjendjen me notën 1, 42% e vlerësojnë gjendjen me notën 2, 16% e vlerësojnë gjendjen me notën 3, 5% e vlerësojnë gjendjen me notën 4, dhe 0% e vlerësojnë gjendjen me notën 5.

Te përgjigjet e organizatave qytetare 27% e të anketuarve e vlerësojnë gjendjen me notën 1, 55% e vlerësojnë gjendjen me notën 2, 18% e vlerësojnë gjendjen me notën 3, 0% e vlerësojnë gjendjen me notën 4 dhe 0% e vlerësojnë gjendjen me notën 5. Te përgjigjet e përfaqësuesve të sipërmarrjeve 50% e të anketuarve e vlerësojnë situatë me notën 1, 25% e vlerësojnë gjendjen me notën 2, 13% e vlerësojnë gjendjen me notën 3, 13% e vlerësojnë gjendjen me notën 4, dhe 0% e vlerësojnë gjendjen me notën 5.

**Grafiku 13. Pasqyra e bashkëpunimit të përfaqësuesve të sipërmarrjeve dhe të organizatave qytetare në komunitet, në rajonin e Tetovës**



**Burimi: Anketë për bashkëpunim me organizatat qytetare dhe Anketë për bashkëpunim me sipërmarrjet**

Nga grafiku mund të shihet se bashkëpunimi i organizatave qytetare dhe sipërmarrjeve është në një nivel shumë të ulët. Vlerësimi për bashkëpunimin e organizatave qytetare është pak më i mirë në raport me vlerësimin e sipërmarrjeve edhe atë për 0.2 pikë. Asnjë sipërmarrje ose organizatë qytetare nuk e ka vlerësuar bashkëpunimin me notën 5. 79% e të gjitha përgjigjeve është me notën 1 ose 2.

Organizatave qytetare konsiderojnë se bashkëpunimi është mjaft i dobët dhe se institucionet shtetërore nuk i shohin si partnerë dhe se ekziston favorizimi i njëmendësve politik. Sipërmarrjet konsiderojnë se bashkëpunimi është shumë i dobët dhe se institucionet janë të mbyllura për bashkëpunim dhe qytetarët kanë besim shumë të vogël në institucionet.

### Shtojcë 1. Pyetësor për organizatat qytetare

1. Назив на организација | Emri i organizatës: \*

Your answer

---

2. Општина на дејствување | Komuna e veprimit: \*

Your answer

---

3. Дали располагате со информации за потребите на жителите на локалната заедницата ? | A keni informacion mbi nevojat e banorëve të komunitetit lokal? \*

- Да | Po
- Не | Jo
- Делумно | Pjesërisht

4. Дали граѓаните се обраќаат кај невладините организации за поддршка или решавање на нивните проблеми во заедницата? | A drejtohen qytetarët drejt sektorit joqeveritar për mbështetje ose zgjidhjen e problemeve të tyre në komunitet? \*

- Да | Po
- Не | Jo
- Немам информации | Nuk kam informata

5. Во која област ги идентификувате потребите на жителите на заедницата ?  
(максимално 2 одговори) | Në cilën fushë identifikoni nevojat e banorëve të komunitetit?(maksimum 2 përgjigje) \*

- Локална инфраструктура | Infrastruktura lokale
- Подобрување на состојбата на младите и еднаквост на жените | Përmirësimi i gjendjes së të rrinjve dhe barazia e grave
- Здравство | Shëndetësi
- Образование | Arsimi
- Работни места | Vendet e punës
- Социјални услуги | Shërbimet sociale
- Other: \_\_\_\_\_

6. Дали имате сознанија за претпријатие кое направило инвестиции за задоволување на социо-економските потреби на жителите во локалната заедницата? | A keni njohuri për ndonjë kompani që ka bërë investime për të plotësuar nevojat socio-ekonomike të banorëve në komunitetin lokal? \*

- Да | Po
- Не | Jo
- Немам информации | Nuk kam informata

Ако одговорот од прашање бр.6 е Да, Ве молиме објаснете | Nëse përgjigja e pyetjes 6 është Po, ju lutemi shpjegoni:

Your answer \_\_\_\_\_

7. Дали сте задоволни од соработката на општината и државните институции со граѓаните, бизнисите и невладините организации? | А јени të kënaqur me bashkëpunimin e komunave dhe institucioneve shtetërore me qytetarët, sipërmarrjet dhe sektorin joqeveritar? \*

1 2 3 4 5

Незадоволни | Тë pakënaqur

Задоволни | Тë kënaqur

Ако одговорот е „Задоволни“, Ве молиме наведете примери на соработка | Nëse përgjigja është "Тë kënaqur", ju lutemi jepni shembuj bashkëpunimi:

Your answer

---

Ако одговорот е „Незадоволни“, Ве молиме наведете зошто сметаат дека соработката не е задоволителна | Nëse përgjigja është "Тë pakënaqur", ju lutemi tregoni pse e konsideroni këtë bashkëpunim të pakënaqshëm:

Your answer

---

## Shtojcë 2. Pyetësor për sipërmarrjet

1. Назив на претпријатието | Emri i sipërmarrjes: \*

Your answer

---

2. Седиште на претпријатието | Vendndodhja e sipërmarrjes: \*

Your answer

---

3. Економски сектор | Sektori Ekonomik: \*

Your answer

---

4. Локација на работење | Lokacioni i veprimtarisë: \*

Your answer

---

5. Дали Вашето претпријатие има направено инвестиции, со кои истовремено помогнала на локалните жители? | A ka bërë kompania juaj investime, me të cilat në të njejtën kohë ka ndihmuar banorët? \*

Да | Po

Не | Jo

Ако одговорот од прашање бр.5 е Да, Ве молиме објаснете на кој начин инвестицијата помогнала за задоволување на потребите на локалната заедница | Nëse përgjigja e pyetjes 5 është Po, ju lutemi shpjegoni sesi investimi ka ndihmuar në plotësimin e nevojave të komunitetit lokal: \*

Your answer

---

6. Кои се придобивките од инвестицијата за остварување на деловните цели на претпријатието?(најмногу 2 одговори) | Cilat janë përfitimet e investimit për të arritur qëllimet e biznesit të kompanisë? (Maksimum 2 përgjigje) \*

- Продуктивноста на локална работна сила | Produktiviteti i fuqisë punëtore lokale
- Репутација | Reputacioni
- Управување со ризиците | Menaxhimi me rreziqet
- Конкурентска предност | Përparësi konkurruese
- Неформално прифаќање/дозвола на бизнис операциите од локалната заедница | Pranimi / autorizimi joformal i operacioneve të biznesit nga komuniteti lokale
- Можност за искористување на земјиште | Mundësia për përdorimin e tokës
- Одобрувања/дозволи од Владата | Miratimet / lejet nga Qeveria
- Следење на глобалните стандарди во индустријата | Ndjekja e standardeve globale të industrisë
- Пристап до одобренија и капитал | Qasja në miratimet dhe kapitalin
- Other: \_\_\_\_\_

7. Дали располагате со информации за потребите на жителите на локалната заедницата ? | A keni informacion mbi nevojat e banorëve të komunitetit lokal? \*

- Да | Po
- Не | Jo
- Делумно | Pjesërisht

8. Во која област ги идентификувате потребите на жителите на заедницата ? (максимално 2 одговори) | Në cilën fushë identifikoni nevojat e banorëve të komunitetit?(maksimum 2 përgjigje) \*

- Локална инфраструктура | Infrastruktura lokale
- Подобрување на состојбата на младите и еднаквост на жените | Përmirësimi i gjendjes së të rinjve dhe barazia e grave
- Здравство | Shëndetësi
- Образование | Arsimi
- Работни места | Vendet e punës
- Социјални услуги | Shërbimet sociale
- Other: \_\_\_\_\_

9. Дали сте задоволни од соработката на општината и државните институции со граѓаните, бизнисите и невладините организации? | A jeni të kënaqur me bashkëpunimin e komunave dhe institucioneve shtetërore me qytetarët, sipërmarrjet dhe sektorin joqeveritar? \*

- 1      2      3      4      5
- Незадоволни | Të pakënaqur                    Задоволни | Të kënaqur



Ако одговорот е „Задоволни“, Ве молиме наведете примери на соработка | Nëse përgjigja është "Të kënaqur", ju lutemi jepni shembuj bashkëpunimi:

Your answer

---

Ако одговорот е „Незадоволни“, Ве молиме наведете зошто сметаат дека соработката не е задоволителна | Nëse përgjigja është "Të pakënaqur", ju lutemi tregoni pse e konsideroni këtë bashkëpunim të pakënaqshëm:

Your answer

---

Доколку Вашата компанија инвестирала во заедницата Ве молиме со клик на ДА да продолжите во вториот дел на прашалникот. Доколку Вашата компанија не инвестирала во заедницата Ве молиме со НЕ да го завршите прашалникот. | Nëse sipërmarrja juaj ka investuar në komunitet, ju lutemi klikoni PO për të vazhduar në pjesën e dytë të pyetësorit. Nëse sipërmarrja juaj nuk ka investuar në komunitet ju lutemi klikoni JO për të përfunduar pyetësorin. \*

Ви благодариме за вашиот придонес | Ju faleminderit për kontributin tuaj

Да | Po

Не | Jo

Botues: Fondacioni Albiz  
[www.albiz.org.mk](http://www.albiz.org.mk)  
[info@albiz.org.mk](mailto:info@albiz.org.mk)  
+389 2 2057 632  
rr.20, nr.97 Saraj, Shkup  
Republika e Maqedonisë së Veriut